

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

***I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 29 MAJ 2003***

***PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 29. 05. 2003. GOD.***

***Qershor - Juni
2003***

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rrugët (2003/7)
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurim publik në Kosovë (2003/13)
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrat të drejtave në pronësinë e paluajtëshme (2003/14)
5. Parashtimi i pyetjeve
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 5 Qershor 2003
 - 6.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për planifikim hapsinor (2003/15)
 - 6.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemën e ndihmës sociale (2003/16)

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pjetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtesa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

Verzioni angleze me mbizotru
Engleska verzija
preovladava
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Друго разматрање Нацрта закона о путевима (2003/7)
3. Прво разматрање Нацрта закона о јавним набавкама на Косово (2003/13)
4. Прво разматрање Нацрта закона о изменама и допунама Закона о оснивању Регистра права на некретнине (2003/14)
5. Постављање питања
6. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 5 јуна 2003
 - 6.1 Прво разматрање Нацрта закона о Просторном Планирању (2003/15)
 - 6.2 Прво разматрање Нацрта закона о шеми социјалне помочи (2003/16)

Опомена : *Питања упучена Влади за усмене одговоре*

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор”
(Правило 21.2 са Привремени пословник)

Verzioni angleze me mbizotru
Engleska verzija
preovladava
English version prevails

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. Second reading of the Draft Law on the Roads (2003/7)
3. First reading of the Draft Law on the Public Procurement in Kosovo (2003/13)
4. First reading pf the Draft Law on the Changes and Fulfilments of the Law on Establishment of the Register on Immovable Property (2003/14)
5. Questions
6. Proposal of agenda for the plenary session of 5 June 2003
 - 6.1 Second reading of the Draft Law on the Spatial Planning (2003/15)
 - 6.2 First reading of the Draft Law on the Scheme of Social Assistance (2003/16)

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

TRANSKRIPT

***I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 29 MAJ 2003***

***KRYESUES I SEANCËS AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR
I KUVENDIT TË KOSOVËS.***

***BASHKËKRYESUES BAJRAM KOSUMI, ANËTAR I KRYESISË
SË KUVENDIT TË KOSOVËS.***

Seanca filloj i punën në orën 10,00

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirëseerdhët në Seancën e rregullt të Parlamentit.

Të gjitha materialet e nevojshme për këtë seancë, i keni marrë me kohë.

Prandaj, fillojmë me rendin e ditës, të paraparë për këtë seancë.

Më parë, kemi një kërkesë të kolegës sime nga Kryesia Nafije Gash. Urdhëroni, e keni fjalën.

NAFIJE GASH:

Sayın Başkan derli millet ve kileri,

Zonja dhe zotërinj deputetë, dola këtu që t'ju njoftoj dhe të shpreh reagimin lidhur me mosrealizimin dhe moszbativimin e Vendimit të

Kuvendit të Kosovës, datë 23 maj 2002 nga autoritetet ekzekutive ndërkontinentare e vendore.

- Duke u nisur nga fakti se kaloi një vit i plotë nga marrja e Vendimit në Kuvend për ndihmë qytetit të Gjilanit me rrethinë përsanimin e pasojave të terrmetit;
- Duke u nisur nga fakti se Kuvendi i Kosovës dhe parlamentarët, unanimisht vendosën për ndihmën prej 5 milion euro përinstitucionet dhe qytetarët e Gjilanit me rrethinë, përfshirë Vitinë dhe Dardanën;
- Duke u nisur nga fakti se qyetetarët nga ne, si deputetë, pyesin dhe kërkojnë më të drejtë se ç'po ndodhë me autoritetin dhe vendimin e këtij institucionit në të cilin shpresojnë dhe kanë besim të plotë;
- Duke u nisur nga fakti se kjo çështje disa herë është shtruar dhe ka marrë mbështetjen e komisioneve të Kuvendit në fazat e diskutimeve buxhetore;
- Duke u nisur nga fakti se kanë ekzistuar mundësitetë reale që këto mjete të ndahen më herët nga suficit i vtit të kaluar;

Kërkojmë me këmbëngulësi të njoftohemi se kush është ai që pengon zbatimin e Vendimit të Parlamentit të Kosovës.

Sot para Kuvendit, edhe një herë, shtrojmë kërkesën dhe iu drejtohemi publikisht kryeadministratorit Shtajner, Këshillit Ekonomik Fiskal dhe institacioneve tjera vendore e vendimmarrëse që, gjatë ndarjes së shumës së mbetur nga suficit i vtit të kaluar, të marrin parasysh me prioritet dhe ta implementojnë Vendimin e Kuvendit të Kosovës, të datës 23 maj 2002 për ndihmën prej 5 milion eurosh regionit të Gjilanit.

Duke shprehur rrrespektin për vëmendjen dhe mbështetjen tuaj, këtë kërkesë e përsërisim në emër të deputetëve nga Gjilani. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Më lejoni t'i dëshiroj mirëseardhje ministrave, sepse s'i vërejta të gjithë dhe në të njëjtën kohë të kërkojmë me këmbëngulësi rrespektimin e vendimeve të Kuvendit të Kosovës.

E dij që Qeveria dhe Ministriaa për Financa kanë qenë pro realizimit të këtij Vendimi. Pra, edhe një herë kërkojmë me këmbëngulësi nga ministri i financave, që është këtu, dhe Qeveria që ta ekzekutojnë Vendimin, ndërsa kërkoj ndërgjegjësim të atyre që stopuan një kohë të gjatë realizimin e vendimeve.

Shpresoj se të gjithë kanë kuptuar mirë porositë dhe besoj më në fund qytetarët e Gjilanit do ta fitojnë atë që Parlamenti, njëzërit, ka vendosur.

Vazhdojmë me rendin e ditës:

Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kalukar.

Besoj se do ta ndjekim atë praktikën që, nëse ka ndokush sygjerime a vërejtje, t'i bëjnë me shkrim.

Meqë s'ka vërejtje në Procesverbal, kalojmë në: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rrugët.

Të gjitha përgatitjet e duhura janë bërë me kohë.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projekligji pë rrugët ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka konstatuar se Projektligji për rrugët nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Çdo amendament i propozuar më poshtë, në mënyrë specifike, reflekton qëndrimet e komisioneve.

Fillojmë me amendamentet. Urdhëroni...

BAJRUSH XHEMAJLI:

Të pranishëm të nderuar, unë ju përshndes të gjithëve. Desha një vërejte, kështu që besoj se jeni dakord se materialet po i marrim vërtetë vonë. Tash kur po bëjmë shqyrtimin e dytë, amendamentet i kemi marrë pesë minuta më parë dhe po shndërrohem që të mos mundemi të bëjmë krahasimin në mes projektligjit dhe amendamenteve. Këto që na janë ofruar tani, po shndërrohem kështu si në një makinë votimi. Mendoj askush nuk do të ketë kohë ta bëjë një krahasim të tillë. Prandaj, do të ishte mirë që Sekretaria t'i sjellë me kohë, ose të shtyhet pikë për një ditë tjeter. Në parim po flas, dhe s'po them që sot ta bëjmë këtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë plotësisht pajtohem me vërejtjet. Komisionet kanë përfunduar punën dje pasdite. Do të thotë arsyaja është me vend dhe edhe në Kryesi kemi patur si diskutabile se a do të arrijmë ta bëjmë si duhet. Në qoftë se Seanca sheh të arsyeshme ta votojmë apo ta heqim nga rendi i ditës, unë s'kam asgjë kundër. Megjithatë, nuk është as kërkesë dhe shpresoj se nuk do të përsëriten më. Lus komisionet dhe Sekretarinë që të mos përsëriten gjérat e tilla.

Amendamenti 1, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

(Vërejtja e Kryesuesit: Ju lutem, përkthimi le të funksionojet!)

A është kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 3 abstenime.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 2, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 8 abstenime.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet funksionale.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 8 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 12 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemndnerit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 9 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Dy propozime të ndryshme: Komisioni funksional dh Komisioni i buxhetit.

Urdhëroni zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, zonja e zotërinj deputetë,

Konform asaj që është thënë edhe më herët këtu, e që është diskutuar edhe në Kryesi dhe i është rekomanduar Komisionit, tërheq vërejtjen se

amendamenti i propozuar i Komisionit për buxhet del jashtë fushëve primit të Komisionit për buxhet, sepse nuk ka të bëjë me implikimet buxhetore e të tjera. Kështu që, propozoj të shqyrtohet dhe votohet vetëm amendamenti i parë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Kryetarët e komisioneve duhet të na ndihmojnë. Urdhëroni, nga Komisioni funksional, Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI:

Inderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe ju ministra,

Prej kohës kur unë kam ardhur në Parlament, që ka qenë 6 muaj pas fillimit të punës, kam vërejtur një fenomen, të cilin vazhdimisht në mënyrë institucionale e kam vë në diskutim. Fenomeni është ai që Komisioni për buxhet në këtë Parlament ka fituar një fuqi të jashtëzakonshme dhe pastaj kjo ka shtyrë këtë Komision që vazhdimisht të tejkalojë kompetencat e veta.

Unë kam biseduar me të gjitha nivelet relevante se çka duhet të bëhet që ky Komision të kthehet në kornizat e veta reale. Në ndërkohe, kam premtimet që do të bëhet një interpretim i ri i Rregullores për punën e Kuvendit, në mënyrë që tash e tutje ndikimi i Komisionit për buxhet të jetë vërtetë në dimensionin e vërtetë sepse unë konsideroj se komisionet funksionale në këtë Kuvend nuk kanë autoritet. Dhe, më lejoni t'ju them se komisionet funksionale po bëjnë një punë të madhe për ta marrë mendimin profesional të spektrit të gjerë përmes dëshmive publike dhe formave tjera të konsultave. Prandaj, unë kërkoj nga deputetët që vërtetë të kenë parasysh dhe t'u japid peshën e duhur komisioneve, natyrisht, gjithnjë duke rrespektuar edhe komisionet tjera. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zoti Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI:

T'falemnderit zoti kryetar, tē nderuar deputetë, tē rrespektuar ministra,

Do tē flas këtu vetëm në kuadër tē kompetencave tē Komisionit pér buxhet.

Komisini pér buxhet, me seriozitetin më tē madh, ka shqyrtuar dhe ka nxjerrë amendamentet që ia ka propozuar përbërjes plenare tē këtij Kuvendi pér shqyrtim dhe miratim.

Amendamentet, që ia ka ofruar Komisioni pér buxhet këtij Kuvendi në Projektligjin pér rrugët, kanë tē bëjnë ekskluzivisht me çështje profesionale dhe lidhen me ato pika ku ka implikime buxhetore. Prej amendamenteve më tē theksuara, që ka dallim në Komisionin funksional, është amendamenti 6, tē cilin e kemi në radhë pér votim, dhe që lidhet me alinenë 8.3 tē nenit 8. Në fakt, amendamenti që është propozuar nga Komisioni pér buxhet, e sanksionon drejtorinë e rrugëve si një organ i cili kryen punë tekniko-profesionale në kuadër tē Ministrisë pér Posttelekomunikacion.

Amendamenti i Komisionit funksional, drejtorinë e rrugëve e avancon në agjencion. Çka do tē thotë kjo pér implikimet buxhetore? Kjo do tē thotë se, në qoftë se me një fjalë, me një nënnen tē këtij ligji, ne themelojmë institucion tē ri do tē bëjmë një dublifikim tē dy institucioneve tona brenda institucioneve tona vetëqeverisëse ekzekutive.

Na është mirë e qartë se pranë Ministrisë pér Posttelekomunikacion ekziston Departamenti pér Infrastrukturë Rrugore. Në qoftë se ne me një fjalë dhe me një nënnen e themelojmë edhe një agjencion, i cili, përkah fusha e veprimtarisë, kompetencat dhe obligimet e veta – tejkalon

fushëveprimtarinë e drejtorisë së rrugëve të nivelist aktuale të organizimit, kjo nënkuption dyfishim të shpenzimeve buxhetore të dy institucioneve, pothuaj, paralele. Prandaj, insistimi i Komisionit për buxhet është ky.

Çështja e dytë, që flet në favor të propozimit të Komisionit për buxhet, është se agjencionet, në bazë të Rregullores 2001/19, që është rregulllore që rregullon organizimin e Qeverisë dhe ministrive tona, përshkruan saktësisht mënyrën dhe procedurën e formimit të agjacioneve. Deri tash kemi 3 agjacione për themelimin e të cilave nevojitet akt i posaçëm normativ, duhet ligj i veçantë ose një akt tjeter i cili mund të bëhet në pajtim me institucionet tona dhe me iniciativët e tyre.

Prandaj, në qoftë se vendoset për themelimin e agjencionit, ka implikime buxhetore. Forma dhe vëllimi i mjeteve të nevojshme ndryshon shumë te drejtoria dhe agjacioni. Do të kemi paralelisht dy shërbime, që do të financohen po nga buxheti. Dhe, në variantin e propozuar në këtë ligj, nga ana e Komisionit për buxhet, kjo mundësi eliminohet.

Dua t'ju përkujtoj, kolegë të nderuar, se Komisioni për buxhet ka bërë një përpjekje për harmonizim të qëndrimeve me Komisionin funksional. Unë dje kam marr pjesë në punën e Komisionit funksional në orën 10 dhe jemi pajtuar për një amendament me një përbajtje për të cilën të gjithë janë pajtuar. Pas përfudnimit të takimit, dhe para fillimit të punës së Komisionit për buxhet, më kanë njoftuar se Komisioni funksional ka mbajt edhe një mbledhje pa prezencën time dhe janë rikthyer në versionin e parë që kanë patur. Singalisht t'ju them, kjo më ka lënë përshtypje të një pune joserioze në Komision.

Unë stojo përbërjen e këtij Kuvendi, që propozimin e Komisionit për buxhet ta votojë dhe në qoftë se shohim të arsyeshme institucionet tona, ta fillojnë procedurën për themelimin e një institucioni që do të quhej agjpcion dhe unë personalisht nuk do të kisha asgjë kundër. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Mund t'na ndihmojë Komisioni për legjislacion... E ka fjalën zoti Arsim Bajrami. Pastaj, le të përgatitet sponsori i ligjit, ministri...

ARSIM BAJRAMI:

I nderuar kryetar, mendoj se s'është herë e parë që kemi një konflikt për kompetenca të komisioneve. Në fakt kemi moskuptim - të rolit, të komisioneve kryesore, që e kanë edhe me Rregullore të punës, edhe me Kornizë kushtetuese.

Ju e dini, se të gjitha ligjet e Kuvendit të Kosovës, para se të shqyrtohen në Kuvend, kalojnë nëpër tri komisione: në Komisionin për buxhet, në Komisionin për komunitete, në qoftë se ai implikohet, dhe me Rregulloren e re të punës, edhe në Komisionin për çështje legjislative, çështje gjyqësore dhe kornizë kushtetuese. Mirëpo, në praktikë këtu, kemi konfuzion, për shkak se nuk kuptohet cila është detyra e komisioneve krysore. Nëse komisioni kryesor, njëkohësisht nuk është edhe komision funksional, ai nuk shtrohet në përbajtjen e ligjit. Vetëm e shqyrton ligjin, nga aspekti i përgjegjësisë së vet; Komisioni legjislativ, nga aspekti i bazueshmërisë në Kornizë kushtetuese; Komisioni për komunitete, nga aspekti se ligji a cenon interesat e komuniteteve dhe Komisioni për buxhet çfarë implikime buxhetore ka ligji. Shpeshherë po na ndodhë që këto komisione kryesore po marrin edhe rolin e komisionit funksional, do të thotë, po shtrohen në përbajtjen e ligjit, gjë që nuk është praktikë e mirë.

Unë nuk jam i sigurt se a ka implikime buxhetore fakti që është implikuar Komisioni për buxhet, por derisa kemi një Komision funksional, unë mendoj se përparësi duhet dhënë Komisionit funksional, për shkak se ai është më kompetent për këtë çështje.

Në anën tjetër, çështja që këtu shtrohet, është pak edhe çështje statusore – çështja e statusit së drejtorisë së rrugëve dhe mendoj se kjo çështje më së miri duhet të zgjidhet nga Komisioni funksional, i cili edhe është adekuat për atë çështje.

Përndryshe, në qoftë se vazhdojmë kështu për çdo ligj, me dalë me qëndrime të kundërta, vetëm se do ta komplikojmë procedurën ligjvënese.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju faleminderit Ministri sponsorues...

ZEF MORINA:

I nderuar zoti kryetar, Kryesi e nderuar e punës, zonja e zotërinj deputetë, kolegë ministra,

Komisioni parlamentar i transportit dhe telekomunikacionit, ka propozuar amendamentin 11, në nenin 8 të Projektligjit mbi rrugët që pas pikës 8.3 të shtohet pika 8.4 ku definohet statusi i drejtorisë së rrugëve duke avancuar në agjencion ekzekutiv të rrugëve. Ky definim, me këtë amendament të propozuar, i cenon drejtpërdrejt kompetencat e Ministrisë së Transportit dhe të Posttelekomunikacionit, të përcaktuara me ligj. Drejtoria e rrugëve që është në kuadër dhe në përgjegjësi të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, kryen detyrat tekniko-profesionale, zhvillimore dhe organizative për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të Kosovës. Agjencitë ekzekutive ekzistuese janë themeluar me Rregulloren mbi Qeverinë e Kosovës 2001/19, e cila është ende në fuqi. Qeveria përcakton nevojën për themelin e agjencioneve ekzekutive të reja të cilat duhet të veprojnë brenda ministritëve të caktuara nën autoritetin e ministrisë përkatëse. Agjenci ekzekutive të reja mund të themelohen me ligj të veçantë dhe buxheti i tyre sigurohet nga ministria, në kuadër të së cilës veprojnë. Ju e dini që buxhetin veç e kemi kaluar ne

për këtë vit. Agjencinë ekzekutive e udhëheqë kryeshefi ekzekutiv i cili emërohet nga komisioni për emërimet funksionale në procedurë të njëjtë, sikurse sekretarët permanent të ministritive. Domethënë, e ngrisim aq lartë, saqë kjo automatikisht bjen ndesh me Rregulloren 2001/19.

Konsiderojmë që avancimi i Drejtorisë së Rrugëve të Kosovës në agjencion ekzekutiv, nuk ka bazë ligjore, sepse, nëse themelohet, kjo duhet të jetë me një ligj të veçantë.

Në vendet e Bashkimit Evropian, por edhe në vendet e regionit të Evropës Juglindore, kryesisht janë të themeluara drejtori të rrugëve të cilat janë nën kompencë të ministrisë përkatëse. Me ngritjen e statusit të drejtorisë së rrugëve në agjencion ekzekutiv, Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit të Kosovës, konsideron se i ngushtohen kompetencat që i takojnë në bazë të Rregullores 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës.

Në parim nuk jemi kundër që të shtohet pika 8.4 sipas këtij amendamenti, por propozoj që ky formulim të jetë me këtë përbërje: "Drejtoria e rrugëve kryen detyrat tekniko-profesionale në kuadër të Ministrisë së Transportit dhe të Posttelekomunikacionit".

Këtu është edhe neni 8.3. Në qoftë se 8.4-shi shkon dhe 8.3 janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, s'di atëherë pse nuk është kërkuar që të hiqet 8.3-shi.

Pastaj, dëshiroj t'ju them se Rregullorja mbi punën e Qeverisë, ende është në fuqi dhe derisa ministria nuk kërkon që të krijohet një agjencion, sipas rregullores, në kuadër të ministrisë, Parlamenti nuk ka të drejtë ta bëjë këtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Fatmir Sejdiu, si anëtar i Kryesisë.

FATMIR SEJDIU:

T'falemnderit, zoti kryetar. Të nderuar kolegë dhe ministra,

Nuk do të pajtohesha me fjalën e fundit që zoti Morina e thotë se Parlamenti nuk mund të bëjë përcakttime. Parlamenti mund të inicojë që të nxjerrë ligj të posaçëm, mund të inicojë të nxjerrë ligj të posaçëm për rregullimin e materies nga kuadri i fushëveprimit të vet, pra edhe për organizimin e ri të Qeverisë së Kosovës – një.

Çështja e dytë, rreth interpretimeve. Mendoj se mund të pajtoihem me një pjesë të formulimeve, se interpretimet nga ana e Komisionit të buxhetit hyjnë në ato formula të cilat praktikisht bëjnë implikimet buxhetore në esencën e vet. Dhe, nëse amendamente të caktuara, insistojnë në korniza, të cilat kapërcejnë strukturën ekzistuese dhe të cilat drejtpërsëdrejti nxjerrin implikime buxhetore, e drejtë është e këtij Komisioni që të intervenojë.

Çështja e tretë. Në amendamentin e dhënë nga Komisioni funksional, është dhënë shumë, nëse e lexoni me vëmendje, kontravers: “Drejtoria e Rrugëve të Kosovës është agjencion ekzekutiv”. S’mund të jetë edhe drejtori edhe agjencion. Është: ose njëra – ose tjetra. Me Rregulloren 19/2001 është e përcaktuar struktura e agjencioneve që shkojnë në rangun gati të ministrike. Ato janë, hëpërhë, të ministrike të Kosovës, të shërbimeve publike apo të ministrike të tjera, struktura tjetër nevojitet apo ka nevojën e një akti të drejtpërdrejtë të veçantë për rregullim të kësaj materie.

Prandaj, në esencë – finalisht, nëse s’miratohen edhe njëri edhe tjetri, por mbetet struktura qysh ka qenë, nuk prishë punë, por kujtoj: precizimi qysh është dhënë nga Komisioni i buxhetit, në këtë rast, pra si formulim tepër e ka natyrën e vet. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Edita, keni drejtë në replikë, por emri nuk ju është përmendur. Urdhëroni...!

EDITA TAHIRI:

Meqenëse po kemi interpretim juridike, së pari dëshiroj të pyes juristët këtu, të cilët janë duke u përpjekur të kontribuojnë për ta sqaruar situatën: - Çka nënkupton definicione, i cili është dhënë nga Komisioni për buxhet – Drejtoria e Rrugëve të Kosovës vepron në kuadër të Ministrisë për Transport dhe Telekomunikacion. Çka është kjo? Çfarë definicioni kjo i jep drejtorisë? Çfarë është formulimi. vetëm vepron? Prandaj, lus juristët tash për këtë interpretim. Ndërkohë, më lejoni t'ju them, në diskutimin tim për fenomenin me të cilin ne po ballafaqohemi, që Komisioni për buxhet po i tejkalon kompetencat, unë nuk desha të lëshohem në shembuj konkret.

Me datën 8 maj, Komisioni për buxhet është ai që e ka orientuar gabimisht këtë Parlament i cili ka votuar me ia marrë Parlamentit kompetencën dhe me bë bordin mbikëqyrës për PTK dhe ka pranuar idenë që ministria, e cila fare nuk ka menduar për bord initialisht t'ia japë këtë kompetencë. Ndërkohë që unë nuk habitem që zoti Morina është kaq i inkurajuar. Sepse, ai, në kohën kur e kanë prezantuar draftligjin për telekomunikacion, PTK fare nuk ka figuruar dhe Komisioni funksional ia ka kompletuar sensin duke inkorporuar PTK-ën. Dhe, në ndërkohë, në këtë Parlament, më 8 maj, pa u pyetur Komisioni funksional, është bërë ndërrimi, është marrë kompetenca e Parlamentit, natyrisht edhe me miratimin e krejt juve dhe të kryetarit.

Prandaj, unë nuk habitem për inkurajimet që po i shoh!? Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni, kryetari i Grupit Parlamentar...

SABRI HAMITI:

Unë dëgjova argumentimet dhe kundërargumentimet dhe, për të mos folur përmendësh, ja me veti e kam këtë ligj. Ja, me veti kam edhe propozimet tuaja, dy variantë. Një variantë, që është i Komisionit funksional. Të dy variantat janë, vërtet shtesa, nuk korrigohet kurgjë në nenin 8, por përtej pikës 8.3 don të shtohet si precizim pika 8.4. Domethënë janë dy variante për një tekst që shtohet.

Pika 8.3 thotë: *Ministria, me akte të vecanta, përkaton rregullat specifike dhe kompetencat e departamentit, infrastrukturës rrugore të ministrisë dhe të drejtorisë së rrugëve. Në shtesë, njëra pretendon që këtë drejtori ta ngrisë në një agjencion kështu, të themi shkurt – përmes një dere të vogël. E tjetra, është një tautologji që nuk thotë kurgjë të re, pos e përshkruan, në një mënyrë, në variant krejt tjetër nenin 8.3.*

Unë propozoj që të mos votohen as varianti i Komisionit funksional, as varianti i Komisionit të buxhetit, sepse bash nuk thojnë kurgjë të re rrëth ligjit. Dhe, le të mbetet neni 8, qysh është, me tri pikat që ka. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Sabri, të falemnderit. Na e lehtësove punën. Prandaj, unë mendoj se, meqë janë amendamente, duhet patjetër të procedojmë.

Kush është për variantin nën a) Komisioni funksional.

Le të numërohen votat dhe ju lutem t'i ngritni duart kush është për këtë variantë. Ju falemnderit.

Kush është për variantin nën b)? Askush. Ju falemnderit.

Kush është për, që të jetë si në Ligjin origjinal që kemi aprovuar, me propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të LDK?

Ju lutem, miratohet faktikisht Ligji siç ka qenë.

Për variantin a) kanë votuar 36. Të pranishëm janë 99 deputetë.

Për variantin b) vetëm 12. Prandaj mbetet si ka qenë, nuk ndryshohet asgjë dhe asnjeri amendament nuk kalon.

Vazhdojmë më tutje.

Amendamenti 7 Dy propozime të ndryshme: Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.

Komisioni për buxhet tërhiqet. I bashkëngjitet komisionit funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 13 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8 Komisioni funksional, pa përkrahje nga Komisioni i buxhetit.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Një kundër.

A abstenon ndokush? 13 abstenime.

Kalon amendamenti.

A abstencion ndokush? 17 abstentime.

A ka kush kunder? Nje kunder.

Kush eshte per? Ju jalemnderit.

per buxhet.

Amendamenti 11. Komisioni funksional, pa perkrahje nga Komisioni

Kalon amendamenti.

A abstencion ndokush? 16 abstentime.

A ka kush kunder? Askush.

Kush eshte per? Ju jalemnderit.

kryesor.

Amendamenti 10. Komisioni funksional, i perkrahuar nga Komisioni

per punë.

(Verjetje e kryesuesit: Nofikiq, publikisht te terhiqet verjetja - qeteesi,

Kalon amendamenti.

A abstencion ndokush? 15 abstentime.

A ka kush kunder? Askush.

Kush eshte per? Ju jalemnderit.

Amendamenti 9. Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni kryesor.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 17 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni funksional, i përkrahur nga Komisioni kryesor.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

Kush abstenon? 17 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 17 abstenime.

Kalon amendamenti.

Kalon amendamenti.

A abstencion ndokush? 17 abstetime.

A ka kush kundër? Askush.

Kush është për? Ju falëminderit.

Amendamenti 17, Komisioni i juksiional dhe Komisioni i buxhetit.

Kalon amendamenti.

A abstencion ndokush? 17 abstetime.

A ka kush kundër? Askush.

Kush është për? Ju falëminderit.

Amendamenti 16, Komisioni i juksiional dhe Komisioni i buxhetit.

A abstencion ndokush? 17 abstetime.

(Vërejtje e kryesuesit: A ta që po abstenojnë nuk janë të thirrur me
bë debate gjatë procedimit të amendamenteve, ju lutemi!)

A ka kush kundër? Askush.

Kush është për? Ju falëminderit.

Amendamenti 15, Komisioni i juksiional dhe Komisioni i buxhetit.

Amendamenti 18, Dy propozime identike me dallim lidhur me shumën minimale të xhobës: Komisioni funksional dhe i buxhetit.

Kush është për propozimin e Komisionit funksional? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 20 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19, Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.

Kush është për? Ju falemnderit.

Urdhëro, keni të drejtë.

GANI KOCI:

Kërkoj falje që po dal në këtë formë, por desha për sqarim. Ne në Komisionin për buxhet kemi patur amendament të veçantë rreth kësaj, do të thotë vetëm një ndryshim të vogël dhe amendmaneti i Komisionit për buxhet ka qenë ky: të ardhura te krijuara nga tarifat e mbledhura, ose dënimet e vendosura sipas këtij ligji derdhen në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Ky ka qenë vendimi i Komisionit për buxhet dhe jo në formën si është prezantuar – si amendament i përbashkët. Prandaj, do të kisha dëshiruar që edhe kryetari i Komisionit këtu ta sqarojë këtë çështje. Mua më duket absurde ajo që kështu në këtë formë është formuluar – të ardhura te krijuara, tarifat e mbledhura ose dënimet e vendosura sipas këtij ligji, i dërgohen... do t'i dërgohen ministrisë, me postë, me tren, a me komunikacion a qysh, me imell dhe ministria pastaj ose zarfë do t'i derdhë në fondin e konsoliduar të Kosovës. Dihet kush menaxhon me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës, prandaj më duket shtesë e tepërt t'i dërgohen ministrisë dhe ministria t'i deponojë në

buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Prandaj, duhet të hiqet kjo se është e tepërt dhe është një shtesë me të cilën ne nuk jemi pajtuar si Komision i buxhetit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit zoti Koci, kryetari i Komisionit funksional besoj e mbështet këtë që e tha, por megjithatë keni të drejtë.

EDITA TAHIRI:

Meqë është çështje për financa, ne i japim përparësi mendimit të Komisionit për buxhet dhe besoj se Komisioni ynë do ta përkrahë Komisionin për buxhet.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Prandaj, kush është për versionin e Komisionit për buxhet, me sqarimet e zotit Koci. Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 17 abstenime.

Kalon amendamenti i Komisionit për buxhet, versioni original.

Amendamenti 20, Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 17 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21, *Dy propozime të ndryshme:
Komisioni funksional dhe Komisioni i buxhetit.*

*Ju lutem deputet, janë komisionet që i kanë bërë dhe janë të pranishëm
në sallë dhe le të deklarohen.*

Kush është për Komisionin funksional? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 22 abstenime.

Kalon amendamenti i versionit funksional.

*Më duhet ta jap një sqarim. Le të numërohen votat mirë nga ata që kanë
për detyrë ta bëjnë këtë. E dyta, nuk mund deputetët t'i shohin në rendin
e dytë – kush po voton apo kush s'po voton prapa. Le të numërohen
votat si duhet.*

*Dhe, në fund, ju ftoj ta votojmë ligjin në tërësi, me amendamentet e
paraqitura.*

*Kush është për, i lutem le të deklarohet me ngritjen e dorës. Ju
falemnderit.*

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon kush nga votimi? 17 abstenime.

Konstatoj se Ligji është i aprovuar.

Votimi – Glasanje – Voted:

- *Për – Za – For* *Shumica – Vecina – Majority...*
 - *Kundër – Protiv – Against* *00*
 - *Abstenuan – Uzdrzanih – Abstained...* *17*
-

(Duartrokitje)

Është kërkesë nga deputetët që të bëjmë një pauzë prej 30 minutash dhe pastaj të vazhdojmë punën.

*(Vijon pauza)**(Pas pauzës prej 30 minutash, Seanca vazhdoi punën)*

***SEANCËN PLENARE NË VAZHDIM E KRYESOI
BASHKËKRYESUESI BAJRAM KOSUMI, ANËTAR I KRYESISË
SË KUVENDIT TË KOSOVËS.***

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Lus deputetët t'i zënë vendet e tyre.

Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën. Të pranishëm janë 90 deputetë, që do të thotë se kemi kuorum të mjaftueshëm për punë.

Në vijim për shqyrtim është pika e dytë e rendit të ditës – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Kosovë.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 7 maj 2003 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, sipas Rregullorës, Rregulla 31.1.

Ftoj ministrin e shërbimeve publike, zotin Jakup Krasniqi, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezentojë Projekligjin.

Urdhëroni zoti ministër.

JAKUP KRASNIOI:

E nderuar Kryesi e punës, të nderuar deputetë dhe ministra,

Në bazë të Kornizës kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë, Rregullores së UNMIK-ut 2001/9, veçanërisht të neneve 5.1, pika b), 5.7, 9.1, 9.1.26, 9.3.pika 3 dhe 11.2 dhe sipas udhëzimit administrativ të Zyrës së kryeministrit 2002/1, procedurën e përpilimit dhe të parashtrimit të ligjeve dhe dokumenteve tjera të Qeverisë dhe të Kuvendit, Ministria e Shërbimeve Publike, hartoi Projektligjin për prokurimin publik.

Qëllimi dhe arsyet e miratimit të këtij ligji

Arsyet për nxjerrjen e ligjit të prokurimit publik janë të shumta dhe të një rëndësie të veçantë në këtë fazë të procesit zhvillimor të Kosovës.

Ky ligj ofron zgjidhje së istemore për konsolidimin, racionalizimin dhe përparimin e rregullativës ligjore të prokurimit publik në Kosovë përmes të cilët sigurohet një bazë unike ligjore për ushtrimin e aktiviteteve prokuruese të njësive të sektorit publik, si dhe të ndërmarrjeve që kanë të drejtë të veçanta dhe ekskluzive për ofrimin e shërbimeve publike në Kosovë.

Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji, në fazën e tanishme të zhvillimit në Kosovë, është sigurimi i përdorimit sa më efikas, transparent dhe jodiskriminues i mjeteve buxhetore dhe i fondeve të ndërmarrjeve tjera Publike që janë të një rëndësie të veçantë për Kosovën. Prokurimi publik deri më tani në Kosovë është kryer në bazë të disa akteve legjislativi të UNMIK-ut, të cilat kanë qenë të paramenduara të jenë të një karakteri të përkohshëm. Andaj, është paraqitur nevoja e ngutshme e nxjerrjes së një ligji gjithpërfshirës dhe detal për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore dhe fondeve tjera me karakter publik në Kosovë.

Përmes këtij ligji themelohen rregullat dhe metodat e veçanta të prokurimit publik të cilat autoritetet kontraktuese dhe operatorët e shërbimeve publike i përdorin për dhënien e kontrataje publike.

Ky Projektligj është hartuar në bashkëpunim me institucionet më relevante evropiane dhe ndërkombëtare, ku janë implementuar të gjitha urdhëresat dhe standardet e UE-së dhe praktikat tjera ndërkombëtare nga fusha e prokurimit publik.

Ministria e Shërbimeve Publike, gjatë hartimit të këtij Projektligji ka patur mbështetje të fuqishme nga institucionet më të rëndësishme, siç janë: USD-ea, AER-i, GTZ, Banka Botërore dhe SIGMA, ndihmë kjo që do të jetë në dispozicion edhe në të arëdhmen me qëllim të zbatimit të këtij ligji në jetën e përditshme.

Objekti i trajtimit të këtij ligji

Ky ligj, si objekt trajtimi, ka rregullimin e aktiviteteve të prokurimit të mallërave, shërbimeve dhe të punëve ku në veçanti synohet:

- *sigurimi i transparencës gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;*
- *nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në aktivitetet e prokurimit publik;*

- nxitja e konkurencës në prokurim në mes operatorëve ekonomik për prokurimin e mallërave, shërbimeve dhe punëve;
- sigurimi i trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik gjatë aktiviteteve të prokurimit.

Struktura përbajtësore e këtij Projektligji

Ky ligj është i hartuar në 9 pjesë të cilat janë të shkoçitura nëpër krere dhe nene dhe nënpika të tyre.

Pjesa e parë e këtij ligji, përmban dispozitat e përgjithshme, ku në veçanti trajtohen: qëllimi; fushëveprimi; përjashtimi dhe përkufizimet; parimet e përgjithshme; kërkesat e përgjithshme; klasifikimi i kontratave publike dhe konkuruesve të projektimit; inicimi i aktiviteteve të prokurimit publik.

Pjesa e dytë, përmban rregullat dhe kontratat publike në të cilat janë të përfshira: rregullat për specifikimet tenike dhe dosjet e tenderit; llojet dhe zbatueshmëria e procedurave të prokurimit; rregullat mbi reklamimin dhe transparencën; udhëheqjen e procedurave të prokurimit; kërkesat e përshtatshmërisë.

Pjesa e tretë e këtij ligji, përmban rregullat për konkuruesit e projektimit.

Pjesa e katërtë e ligjit, përmban rregullat shtesë mbi kontratat e punëve dhe koncensionin në të cilin përfshihen: rregullat për dhënien e kontratës me koncesion nga autoriteti kontraktues; rregullat mbi kontratat e dhëna nga koncessionerët.

Në pjesën e pestë, bëhet fjalë për organin rregulatoriv të prokurimit publik.

Në pjesën e gjashtë, përshkruhen themelimi dhe aktivitetet e agjencionit të prokurimit publik.

Pjesa e shtatë, përmban rregullat mbi themelimin e komisionit rregullativ të prokurimit publik.

Pjesa e tetë, përmban procedurat e shqyrtimit të prokurimit publik, ku në veçanti përfshihen: Dispozitat e përgjithshme; panelet shqyrtuese; thirrja dhe inicimi i procedurave të shqyrtimit; procedura para paneleve shqyrtësuese dhe raportimi.

Pjesa e nëntë, përmban mjetet juridike; dispozitat ndëshkimore dhe çështjet përfundimtare ku në veçanti përfshihen: shkeljet e ligjit dhe ndëshkimet; dispozitat përfundimtare.

Të nderuar deputetë, siç ceka më lart, ligji mbi prokurimin publik, është një akt kyç dhe një hap shum i rëndësishëm drejt racionalizimit të aktiviteteve të prokurimit në Kosovë dhe shfrytëzimit sa më të drejtë, efikas dhe transparent të buxhetit të Kosovës.

Ky ligj, gjithashtu, është edhe një hap drejt luftimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit të fondeve publike.

Së fundi, apeloj që ky ligj, të miratohet sa më parë, në mënyrë që të gjejë zbatim në jetën e përditshme të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit, zoti ministër.

Tani hapim debatin për ligjin për prokurimin. Ju përkujtoj edhe një herë se debati apo shqyrtimi i sotëm është i përgjithshëm, është shqyrtim parimor. Domethënë, nuk është kohë kur bëhen amendamente por jipen opione të përgjithshme, ide të përgjithshme lidhur me

Projektligjin dhe ato opinione, që do të jipen sot këtu, do t'i kenë parasysh komisionet gjatë shqyrtimit të Projektligjit.

E ka fjalën Nerxhivane Dauti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK.

NERXHIVANE DAUTI:

Inderuari zoti kryesues, të nderuar deputetë,

Ligji mbi prokurimin publik në Kosovë, është i një rëndësie të veçantë për Kosovën që siguron një bazë të unifikuar ligjore për ushtrimin e prokurimeve nga njësitë në sektorin publik dhe ndërmarrjet që kanë të drejta të veçanta për ofrimin e shërbimeve publike dhe për të siguruar përdorimin efektiv dhe transparent të fondeve publike dhe fondeve të ndërmarrjeve dhe që janë të drejta ekskluzive për t'i ofruar publikut shërbime publike.

Gjer më tanë në Kosovë, prokurimi publik është rregulluar me akte legjislative të nxjerra nga UNMIK-u, konkretisht Instruksioni administrativ financiar nr. 2/99 dhe Instruksioni i administritmit financiar nr. 13/200 rreth rritjes së limiteve financiare që kanë të bëjnë me prokurimin nën Instruksionin administrativ nr. 2/99. Ligji mbi prokurimin publik do t'i zëvendësojë në tërësi instrukzionet e lartpërmendura.

Ligi përban gjithsej 120 nene dhe ndahet në nëntë pjesë, ku në mënyrë të detajizuar rregullohen:

- *planifikimi i prokurimit;*
- *rregullat për vlerësimin dhe klasifikimin e kontratave publike dhe konkurseve të projektimit;*
- *autorizimi për inicimin e një aktiviteti të prokurimit;*
- *rregullat për kontratat publike;*
- *llojet dhe zbatueshmëria e procedurave të prokurimit;*
- *reklamimi dhe transparenca;*

- udhëheqja e prokurimit;
- procedura e prokurimit dhe rregullat mbi kontratat e dhëna nga konsesionarët;
- rregullat mbi agjencinë e prokurimit publik;
- procedurat e shqyrtimit të prokurimit;

- panelet shqyrtuese;
- mjetjet juridike; dhe
- dispozitat ndëshkimore.

Ky ligj vlenë për të gjitha aktivitetet e prokurimit të autriteteve kontraktuese dhe konsioneve të punëve. Qëllimi i tij është të sigurojë menyrën me ejikase të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë, duke përcaktuar kushtet, procedurat dhe të drejtat e detyrimet që do të përbushen nga operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, konsisionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë aktivitete të prokurimit publik.

Ligji nuk vlenë për aktivitetet e prokurimit të rëndësishme për dhënien e kontratës publike që është në suaza të fushëveprimit të një marrëveshjeje që parasheh zbatimin e rregullave tjera të prokurimit dhe për ndëarmarrjet në pronësi shoqërore që administrohen nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Pra, ligji ofron një kornizë gjithpërfshirëse, që është në pajtim me direktivat e Unionit Evropian dhe standardet e larta ndërkombëtare dhe si i tillë, konsideroj, dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, se i përbushë kushtet për procedim të mëtejshmë. Ju falemnderit për vëmendje.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

T'falemnderit zonja deputete. Fjalën e ka Fatmir Sejdiu.

FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti kryesues. Të nderuar ministra,

Mendoj se ky ligj, që kemi para vetës, është një nga ligjet e rëndësishme dhe, them, shumë të rëndësishme që Kosova duhet ta ketë në këtë fazë, për të ndihmuar rregullimin e një materie tepër të ndieshme, e cila, me të drejtë, kësaj radhe, ka qenë edhe preokupim i Qeverisë së Kosovës dhe do të jetë edhe preokupim yni.

Në parim, mbështes në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës debatin e mëtejshëm lidhur me këtë ligj, përkatësisht miratimin në parim dhe po ashtu mbështes vërejtjet themelore që u shtruan edhe si hyrëse nga ana e ministrit Krasniqi, po ashtu edhe nga deputeta e Partisë Demokratike të Kosovës.

Mendoj se është esenciale, diçka plus dhe paralelisht le të jetë pjesë e hapësirës për meditim për deputetët në fazën e amendamentimit të tij, që gradualisht jemi kah shkojmë bashkë në miratimin apo në ndërtimin e një teknologjie, ta quajmë sa më unike, për legislacion dhe që ligji të ketë një frymë vërtetë tepër të qartë dhe të argumentuar.

Mendoj se, disa nga ligjet, po e them në variantë tjeter, edhe në këtë rast ky, ka n evojë të një rishiqimi jo vetëm në kuptimin e lekturës, por në kuptimin edhe të strukturës së fjalisë. Sepse, struktura apo semantika e secilës fjalë don sqarime apo don thjeshtë kuptimin e saj në esencë. Mendoj se, ajo që do të jetë ndoshta preokupim i drejtpërdrejt, është pjesa e fjalive tepër të gjata; tepër të gjata e të cilat nevojiten të shkoçiten. Ligji është ai që përcakton në mënyrë decidive secilën materie.

Shiqoni, ta zëmë, nenin 1 – qëllimin. Neni 1, pikë 2 e pikë 3 etj., sikur edhe në përbajtjen e brendshme. Është, po them, një nevojë, e këtë mund ta bëjmë bashkë, që të ndahet, të precizohet, të saktësohet, të dihet pozicioni i secilës pjesë të një norme të caktuar.

Dhe, finalisht, duke mbështetur edhe një herë, po them, finalisht atë që patëm pak më parë edhe në debat me rastin e miratimit të Ligjit përrugët, nuk mund të shkohet me rregull që, ta quajmë, secili nga ligjet të ndryshojë. "Ky ligj, - ta zëmë këtu, - hyn në fuqi me datën 1 tetor të vitit 2003." Ku e dijmë se në cilën datë do të jetë!? Do të jetë shumë më herët, ndoshta. Do të bëjmë përpjekje të jetë më herët, por ky ligj hyn në fuqi – ditën e shpalljes. Ajo është rregulla uniforme për të gjitha ligjet dhe s'kemi nevojë të ndalemi, sikur edhe unë tash, të ndalemi rrëth saj e të precizojmë vazhdimisht dhe të jipen amendamentet, diçka që është shumë e thjeshtë. Ju falemnderit. Pra, në parim mbështesim këtë ligj.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit zoti Sejdiu. E ka fjalën deputeti Ibush Jonuzi.

IBUSH JONUZI:

Zoti kryesues, ministra të nderuar dhe deputetë të çmuar,

Projektligjin, i cili sot po debatohet, e mbështes në parim, si edhe parafolësit, sepse me të vërtetë është i një rëndësie të veçantë.

Mendoj se ajo çka është përfshirë në Projektligj, është mjaft përbajtësore, por nuk do të thotë se nuk ka hapësirë përrregullim dhe për një rishqyrtim të detajshëm e në veçanti prej komisioneve profesionale, në mënyrë që ligji në praktikë të jetë shumë më i zbatueshëm dhe shumë më funksional.

Kisha me u ndal shkurt vetëm në dy-tri çështje, dhe sikur që thash i përkrah edhe diskutimet e dy parafolësve më parë, te neni 50: Njoftimi i kriterit për dhënier e tenderit, dhe thotë – kontrata do t'i jipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin me çmim më të ulët ose kontrata do t'i jipet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin më ekonomik. Nëse këto çështje nuk i shqyrtojmë më mirë, në Projektligj me qenë më të precizuara dhe më të definiuara, në praktikë nesër a pasnesër ne kemi

me hasë në probleme shumserioze, që do të thotë, se punët kryhen vetëm formalitet kurse nuk kryhet puna kualitative.

Neni 64 – Aftësia teknike ose profesionale e kryerësve të punëve. Mendoj se edhe kjo është çështje shumë me rëndësi dhe me prioritet për Projekligjin. Pse? Gjatë tenderimit, ofertuesit ofrojnë dëshmi që ndoshta nuk janë dëshmi të bollshme dhe nuk janë dëshmi të cilat dhënë të kuptohet se ai kryerës i punëve apo ai konkuries është i profesionalizuar për kryerjen e atyre punimeve. Dhe, në rrugë e sipër, kur të mirret puna, atëherë vetëvetiu po haset në moskryerje profesionale dhe mosnjohje të lëmisë përkatëse.

Dhe, përfund, mendoj se në Projektligj duhet të parashihet mbikëqyrja profesionale në mënyrë që punët gjatë kryerjes t'i pranojë organi mbikëqyrës profesional në cilësi dhe kualitet. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

T'falemnderit zoti deputet. Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës.

BUJAR DUGOLLI:

Zoti kryesues, të nderuar deputetë,

U dhanë shumë sqarime. Mund të japim një mbështetje për ato deklarime parimore për këtë ligj, rëndësia e tij, u tha, është e madhe dhe ne i bashkëngjitemi këtyre diskutimeve.

Dua të kërkoj nga Qeveria që në “Dispozitat përfundimtare” të jenë unike për të gjitha ligjet, mos të kemi nevojë ne për çdo ligj të dalim dhe t'i diskutojmë dispozitat përfundimtare, kur dihet procedura e hyrjes në fuqi të ligjit. Pra, deklaroj një mbështetje në emër të Grupit Parlamentar, mbështetje parimore për këtë ligj. Normalisht, kontributin

tonë do ta dhëmë në kuadër të komisioneve funksionale dhe komisioneve tjera të Kuvendit. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

T'falemnderit Bujar. Fjalën e ka Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI:

Inderuari kryesues,

Fillimisht, edhe unë dëshiroj ta jap mbështetjen përimore të fillimit të miratimit të ligjit për prokurimin publik, meqenëse prokurimi publik është një praktikë e re që ka filluar në Kosovë dhe është shummirë që në fillim të kësaj praktike ne do të kemi një ligj të Kosovës, i cili do të rregullon këtë materie.

Arsyeja pse dola këtu nuk është përbajtja e ligjit, për shkak se përbajtja e ligjit do të diskutohet edhe me rastin e leximit të dytë, por është një praktikë e harmonizimit të një terminologjje dhe strukture unike legislative.

Ne akoma, edhe në nivel të Qeverisë, edhe në nivel të Kuvendit, nuk kemi një strukturë unike të ligjeve dhe po jemi dëshmitarë se po na vijnë ligje me struktura nganjëherë edhe kundërthënëse. Në anën tjetër, si Kuvend, nuk kemi ndërtuar një komision të veçantë apo një agjencion të veçantë çfarë kanë parlamentet tjera, i cili do të përkujdesej që ligjet të jenë me standarde unike. Po të krahasojmë ligjet që kemi patur në debat dhe ligjet që do të na vijnë do të shohim një divergjencë të madhe sa i përket strukturës legislative.

Unë angazhohem që pranë Qeverisë së Kosovës, por edhe ne të mendojmë një ditë ndoshta edhe pranë Parlamentit të ngrisim një institucion të tillë, mund të jetë edhe një agjencion që do të jetë një partner i Parlamentit, siç është praktika me Kongresin Amerikan, i cili

ka ndërtuar një agjencion për ligjet, si një partner i Kongresit Amerikan dhe mendoj edhe ne një ditë duhet të bisedojmë të krijojmë një institucion të tillë i cili do të standardizonte legjislacionin e Kosovës. Për shkak se, në qof të se vazhdojmë me këto praktika, legjislacioni do të na dalë shumë jokompatibil. U përmendën, për shembull, te rasti që u cek edhe më parë. Po kemi dispozita të ndryshme kalimtare të ligjeve. Sot e kemi dispozitën kalimtare e cila me të drejtë u përmend edhe nga kolegu Sejdiu se duhet të ndryshohet, për shkak se me dispozitën kalimtare është paraparë se ligji do të hyjë në fuqi më 1 tetor. Ne nuk mund të prejudikojmë kur do të hyjë... Ne në këtë drejtim duhet të ndërtojmë një nomenklaturë unike dhe dispozitat kalimtare duhet të jenë unike. Fakti se po na vijnë të ndryshme, po tregon se nuk është një kontrollë e mjaftueshme e ligjeve nga propozuesi, nga Zyra ligjore e cila duhet në këtë drejtim t'i harmonizojë ato.

Përndryshe, nga aspekti i Komisionit legjislativ, ne do të marrim në shqyrtim këtë ligj dhe besoj së do të përgatisim disa amendamente në mënyrë që ky ligj të jetë sa më i mirë dhe më i qëndrueshëm.

Edhe një herë po angazhohem që në një mbledhje, që vetë do ta vlerësojmë, besoj edhe Kryesia do ta marrë parasysh, të mendojmë për këtë dhe të krijojmë një mekanizëm tonin, të Kuvendit të Kosovës, i cili do të kujdeset që ligjet të cilat i miratojmë të janë pakashum me një strukturë unike. Me një strukturë unike për shkak se, ju e dini, përpara kemi patur një praktikë tjetër legjislative. Tani UNMIK-u ka aplikuar një legjislativë tjetër e cila shumë çështje i bën norma që nuk duhet të janë norma. Për shembull, po shihni, qëllimi i ligjit te ne është normë, ose diçka tjetër. Por, nganjëherë kemi edhe konfuzion se çka është materie legjislative e çka është materie shpjeguese. Materia shpjeguese nuk duhet ta ngarkojë ligjin. Momenti, kur ligji vjen në Kuvend, nuk duhet të jetë i përcjellur me materien shpjeguese. Materia shpjeguese duhet të jetë e pranishme në kohën kur ligji është iniciativë. Dhe, kur e miratojmë, e miratojmë vetëm si ligj, siç janë krejt ligjet tjera.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit Arsim. Diskutues tjerë nuk ka.

Prandaj, vë në votim Shqyrtimin e parë të Projektligjit për prokurimin.

Kush është për, i lutem le ta çojë dorën. Është shumica për. Ju falemnderit.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? 12 abstenime.

Me 12 vota të abstenuar dhe asnjë kundër – Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për prokurimin.

Votimi – Glalsanje – Voted:

- Për – Za – For Shumica – Većina – Majority...
 - Kundër – Protiv – Against 00 ...
 - Abstenuan – Uzdrzanih – Abstained ... 12...
-

Më lejoni t'ju them se në bazë të Rregullës 19 pika 6 dhe Rregullës 31, Komisioni për shërbimet publike është Komisioni funksional në shqyrtimin e këtij Projektligji, mirëpo po ashtu të gjitha komisionet që janë të interesuara për materien e Projektligjit, mund të bëjnë amendamente, por përmes prezentimit të Komisionit funksional.

Shpresoj se komisionet brenda afatit trijavësh do ta kryejnë punën e tyre.

Kalojmë në pikën e katërtë të trendit të ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrat të të drejtave në pronën e paluajtshme 2003/14.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve, po ashtu më 7 maj 2003 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Nuk mund të ndërhyjni, vetëm nëse keni çështje procedurale, zoti Saviq. Atëherë, urdhëroni. E ka fjalën Gojko Saviq, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

GOJKO SAVIĆ:

Poštovani predsedavajući, drage kolege,

Ja bih samo u vezi ove četvrte tačke hteo da kažem sledeće. Pazite, ovde стоји – Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopušnama Zakona o osnivanju registra prava na nekretnine. Potpuno, jedna konfuzna situacija! Zakon o osnivanju registra prava na nekretnine je prošao kroz Skupštinsku proceduru, i mi se toga sećamo, ali on, nijednog trenutka, nije zaživeo. Znači, nije validan. Odkud sada, ako ne postoji zakon o osnivanju registra prava na nekretnine, mi razmatramo prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama tog zakona? Ja bih voleo da predsedavajući ili neko koji je odgovoran za ovo objasni jer dolazimo u jednu konfuznu situaciju tako da zbog tih nejasnoća, ja mogu reći i u ime našeg poslaničkog kluba, mi moramo i dalje biti uzdržani na ovo. Hvala.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit zoti deputet. Ky rend i ditës është lexuar në seancën e kaluar dhe ka kaluar nëpër Kryesinë e Kuvendit. Ndoshta mund të keni të drejtë, por tash ka kaluar dhe është pjesë e procedurës dhe nuk mund të ndalemi në gjysmërrugë.

Ftoj zotin Jakup Krasniqi, ministër i shërbimeve publike që të prezentojë para deputetëve Projektligjin e ri...

JAKUP KRASNIOI:

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Kosovës, më 17 tetor 2002 ka aprovuar Ligjin mbi themelimin e regjistrat të të drejtës në pronën e paluajtshme.

Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm ka bërë shpalljen e këtij Ligji Nr. 2005/5, duke e kushtëzuar këtë me aprovimin e amendamenteve plotësuese me të cilat parashihet njoftimi i vërtet publik dhe masat tjera përmbrojtjen e personave, të drejtat e të cilave mund të ndikohen në këtë regjistër.

Ministria e Shërbimeve Publike pajtohet në tërësi me sygjerimin e Sekretarit special, pasi që me aprovimin e këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve të Ligjit dinamizohet programi për themelimin e regjistrat dhe përinicimin e regjistrimeve të të drejtave të pronës së paluajtshme, e cila është një nevojë imediate për qytetarët e Kosovës.

Përbajtja e Projektligjit

Është propozuar që pika 3.3 a); b) dhe c) të shtohen pas paragrafit 3.3, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e zyrave komunale kadastrale përvendosjen e tabelës për shpalljen publike me të cilën do t'u mundësohet të gjithë personave që mendojnë se me një regjistrim të tillë janë privuar nga ndonjë e drejtë lidhur me regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme. Njëherit, me këto ndryshime përcaktohet edhe mënyra e vendosjes së tabelës dhe mënyra e përdorimit të saj.

Me nenin 3.3 pika b) është përcaktuar afati optimal – 5 ditë pune përafishim të njofimit pas të cilës kohë zyra komunale kadastrale mund ta marrë vendimin definitiv lidhur me regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme. Gjithashtu, është pricizuar edhe përbajtja e njofimit publik me të dhënat kryesore, duke filluar nga shënimet e pronës, personave të involvuar në regjistrimin e pronës, përshkrimi i të drejtës dhe afati për paraqitjen e vërejtjes apo kundërshtimit. Duke cekur se përnjofimin e palëve, këto shënime janë të mjaftueshme për pronat e

regjistruara në mënyrë që të ketë mundësi të bëjë ndryshimin nëse mendon se me regjistrim dëmtohet interes i tij.

Me nenin 3.3 pika c) parashihet obligimi i zyrave komunale kadastrale që të bëjnë vërtetimin dhe shqyrtimin e rasteve të regjistrimit të banesave pranë drejtorisë dhe komisinit për kërkesa pronësore-banesore.

Duke patur parasysh se miratimi i këtij Ligji, i plotësuar dhe i ndryshuar do të mundësojë hyrjen në fuqi të Ligjit të nënshkruar Nr. 2002/5 i propozoj Kuvendit që ky Projektligj, me këto ndryshime dhe plotësime, të miratohet. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit zoti ministër. Meqenëse çështja është pak e mjegulluar dhe patti drejtë deputeti Saviq, ftoj kryetarin e Komisinit për legjislacion, po ashtu edhe Fatmir Sejdiu që është paraqitur, të jatin mendimin e tyre lidhur me Projektligjin në ffjalë. A janë amendamente apo projektligj?

ARSIM BAJRAMI:

Vërtet, çështja është pak e komplikuar, meqenëse me rastin e dekretimit apo shpalljes së Ligjit Përfaqësuesi ka vërë disa kushte për ndryshime në Ligj.

Mendoj se në momentin kur ai shpall ligjin, ligji hyn në fuqi dhe më s'ka kushte. Ai para se ta shpallë ligjin, ka mundësi me bë rezerva, rezerva në pajtim me Kornizën kushtetuese në qoftë se ato janë rezerva të qëndrueshme.

Nuk e kam të qart faktin në këto propozime që propozon Ministria e Shërbimeve Publike – a shkojnë në drejtim të përbushjes së këtyre rezervave që ka propozuar Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm apo janë ndryshime që nuk kanë të bëjnë me ato

shqetësimë. Në qoftë se këto shkojnë në atë drejtim që të marrin parasysh vërejtjet që ka dhënë Përfaqësuesi special, tëherë nuk është vonë dhe këto mund të integrohen për shkak se procesi ligjvënës nuk ka përfunduar. Procesi ligjvënës përfundon në momentin kur ligji shpallet. Në qoftë se shkojmë në atë drejtim, pra në qoftë se janë ndryshimet e propozuara në bazë të sygjerimeve që ka dhënë Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm nuk është vonë dhe mundet edhe në këtë fazë Kuvendi t'i marrë parasysh. Në qoftë se janë të natyrës tjetër, atëherë mendoj se këto duhet të paraqiten më vonë, pasi ligji të shpallet dhe Qeveria dhe sponzoruesi ka të drejtë në çdo kohë me propozuar ndryshimin e ligjeve që ka miratuar njëherë Kuvendi. Ka drejtë me propozuar ligje, e jo amendamente tani, por ka të drejtë me propozuar një ligji për ndryshimin e ligjit ekzistues. Amendamentet përdoren derisa ligji është në procedurë ligjvënëse. Momenti kur një ligj shpallet nga Përfaqësuesi special, ai në çdo kohë mund të ndryshohet me ligjin për ndryshimin...

Për këtë arsy, është shumë me rëndësi të sqarohet ky fakt – a kanë të bëjnë këto ndryshime që propozon Ministria e Shërbimeve Publike me këto vërejtje të cilat ministri i konsideroi të arsyeshme me këto vërejtjet që ka dhënë Përfaqësuesi speical. Nëse këto i adresohen këtyre vërejtjeve, është krejt në rregull që Parlamenti t'i marrë në shqyrtim dhe t'i pranojë. Nëse kanë të bëjnë me tjera, mendoj se ajo duhet të ndodhë në një fazë të mëvonshme pasi që ligji të fillojë të zbatohet, sponzoruesi i saj mund ta ngrisë procedurën për ndryshimin e tij.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit Arsim, urdhëroni Fatmir. Më falni Fatmir, pritni një moment, meqë zoti Saviq don replikë.

GOJKO SAVIĆ:

Rečeno je da sam ja iskomplikovao ono što nije iskomplikovano. Tek posle ovih diskusija je to toliko komplikovano da niko od vas, siguran sam, nije razumeo diskusiju. Ali, možda ćete reći i prihvatićete to da jeste tako ali u stvari nije. Malopre rečeno, od strane ministara, kaže: proglašen je Zakon od strane Štajnera. Nije proglašen! Da je Zakon proglašen, on bi zaživeo, ljudi božji. Prema tome, kada nije proglašen, on je u nekoj fijoci. I sada mi govorimo o prvom razmatranju Nacrta zakona. To znači, ako se to vraća u Skupštinsku proceduru onda se to vraća u potpunosti. Ako je gospodin Štajner želeo da to određenim promenama uradi, on bi to u radio, kao što je, mimo vas i mimo vaše želje, uradio i sa Zakonom o visokom obrazovanju – ubacio amandman koji je dat na bazi panela i pustio Zakon kao takav. Ovde se govorи o sasvim drugim stvarima. Zakon ne postoji a mi govorimo o razmatranju Nacrta zakona o Zakonu, koji nije na snazi. Onda je zaista iskomplikovana situacija a objašnjenja su još gora. Hvala.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Urdhëroni Fatmir.

FATMIR SEJDIU:

Ky dokument e thjeshtëson punën, sepse vërtet ishte i komplikuar. Mund ta marrim si të arsyeshme intervenimin, në padjeni se Ligji është shpallë. Por, meqë Ligji është shpallë, çështja është krejt në rregull. Është Ligji ri mbi ndryshimet e Ligjit dhe nuk ka kurrfarë pengese tjetër procedurale. Po të ishte e kundërta, unë mbështes pikërisht atë që shtroi zoti Bajrami më herët, sikur që shtroi edhe zoti Saviq, po përmendi emrin. Nëse ligji nuk është shpallë, është një proces krejt tjetër që Kuvendi do të duhej të mendonte, e edhe Kryesia e Kuvendit, me rastin e vëniies në rend dite. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Oliver Ivanoviq.

OLIVER IVANOVIĆ:

Naša procedura, poštovane kolege, za usvajanje zakona je malo drugačija nego što se to radi u drugim, bilo kojoj drugoj situaciji, i u bilo kom drugom parlamentu. Proces usvajanja zakona se završava njegovim proglašavanjem. To pravnici bi morali znati. Znači on da se primeni ne može dok ne bude potpisani i proglašen kao takav. Do tog trenutka, ja sam tako shvatio profesora Savića, uostalom mislim da će većina vas tako i misli, do tog trenutka nam je moguće, u proceduri koja je propisana, menjati suštinu na predlog predлагаča ili na predlog nekog od poslanika ili poslaničke grupe.

Mislim da smo izgubili mnogo vremena, jer da je predлагаč predložio ovo kao sopstveni predlog, sopstveni amandman i on može amandmanom amandmirati predlog, osnovni predlog zakona. Kad bi odbori danas imali to, mi bi smo danas razgovarali o predlozima odbora, stručnog odbora i ostalih odbora koji su zaduženi da to razmatraju.

Ja bih vam predložio ovako: Da mi ovo skinemo sa dnevnog reda danas. Da do sledeće sednice odbori razmotre i da nam daju svoje mišljenje o amandmanima i mi završavamo proceduru na sledećoj sednici usvajanjem amandmana i odmah usvajanjem celog zakona, u celini, onako. Hvala.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Hydajet Hyseni, e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI:

Inderuari kryesues, të nderuar deputetë,

Çështja është e ndërlikuar, por kam përshtypjen se edhe po e ndërlikojmë ngapak me qëllim. Është e ndërlikuar sepse, siç është thënë edhe përparrë, as Rregullorja jonë nuk e ka sqaruar sa duhet këtë fazë të procedimit në aktivitetin tonë ligjvënës, në përgjithësi. Por, mendoj se është edhe një ndërlikim në tekstet që kemi përparrë. Teksti anglisht, flet për Draftligjin për ndryshimet dhe amendamentimin e Ligjit numër 2002/5 lidhur me vendosjen... e tjera. Është edhe një mospërputhje, do të thotë në tekstet. Në rastin kur ligji është kontestuar nga Përfaqësuesi special i autorizuar për ta shpallur ligjin, nëna mbetet vetëm një procedurë – që të fillojmë, do të thotë, procedurën e rregullt ligjvënësë dhe procedura për plotësimet e ndryshimet e ligjeve dhe kjo është procedurë e rregullt ligjvënësë. Prandaj, mendoj se ky Kuvend duhet të aprovojë propozimin e parashtruar në parim; t'i bartet pastaj komisioneve për të shqyrtuar amendamentet e propozuara ose propozimin e propozuar dhe ne ta shqyrtojmë sipas procedurës së rregullt. Meqë në këtë rast kemi të bëjmë me një ligj të shpallur, atëherë mund eventualisht edhe t'i thirremi dhe referohemi Rregullores sonë që përshkruan shqyrtimin e ashtuquajtur të tretë, sepse edhe ajo krijon mundësinë që amendamentet të shqyrtohen përsëri. Kështu që edhe në këtë variant, ne përsëri jemi në përputhje me procedurën. Prandaj, unë nuk shoh asnjë arsy që ne ta heqim prej rendit të ditës ose ta komplikojmë prej fillimit. Ligji është i shpallur, është një nismë e re nga Qeveria që është e autorizuar të vazhdojë procedurën për plotësimin e ligjeve dhe si Kuvend, ne mendoj se duhet ta aprovojmë sot në parim dhe të vazhdojmë pastaj shqyrtimin nëpër komisione dhe kur të vjen radha edhe ta aprovojmë atë edhe me amendamente si tërësi. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Ju falemnderit zoti Hydajet. Tash u sqaruan të gjitha situatat. Më lejoni ta tregoj tanë procedurën qysh do të shkojmë.

Ligji për krijimin e regjistrave për të drejtën pronësore është pranuar në Kuvend më 5.09.2002.

Shqyrtimi i parë është bërë më 26.09.2002.

Shqyrtimi i dytë më 17.10.2002.

Është miratuar më 17.10.2002 me numrin 2002/5, ndërsa Përfaqësuesi special e ka shpallur dhe ka bërë të plotëfuqishëm më 20.12.2002 me numrin rendor 2002/22.

Do të thotë këtu nuk ka më dilema. Mbetet çështje, do të thotë a janë amendamente a është projektligji, por këtë nuk do ta diskutojmë tash.

Vazhdojmë të procedojmë sipas rendit të ditës, do të thotë Projektligji i ri për plotësime dhe Komisioni për legislacion më vonë ta japë një shpjegim profesional që pasi të miratohet një ligj a ka amendamente apo ka edhe projektligj të ri.

Ju dëgjuat fjalën e ministrit. Nuk ka debat, zoti Arsim dhe nu ka as konfuzion, u sqarua, të lutem. Nëse këmbëngulë, urdhëro...

ARSIM BAJRAMI:

Tani, pas leximit të informatës zyrtare nga kryesuesi e kemi të qartë, e mendoj kjo ka qenë e domosdoshme, menjëherë kur u kontestua nga deputeti Saviq, të lexohet. Ligji është nënshkruar, ligji është në fuqi. Qeveria ka të drejtë në çdo kohë, në çdo kohë me inicuar procedura të reja për ndryshimin e ligjeve ekzistuese. Në këtë rast, iniciativa është krejt e bazuar në Rregullore dhe në Kornizë dhe ne kemi një propozim për ndryshimin e ligjeve dhe procedojmë sikur për të gjitha ligjet tjera. Nuk kemi lexim të tretë, përkundrazi kemi leximin e parë sot dhe shkojmë me procedura të adoptuara.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit. Edhe unë këtë e propozova Arsim. Ne vazhdojmë me procedurën. Do të thotë është në rend dite Shqyrtimi i parë i

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistratit të të drejtave në pronën e paluajtshme.

E ka fjalën, rreth këtij Projektligji dhe në parim të vërejtjeve të përgjithshme, deputeti Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

E nderuara Kryesi, të nderuar deputetë dhe ministra,

U pa se vërtëët ne vijmë në Kuvend pa i lexuar dhe pa u përgatitur përligjet. Këtu mendoj se s'ka patur kurrfarë mosmarrëveshjeje as kurrfarë konflikti. Çdo gjë ka qenë e qartë. Kjo që u tha, është dashur të thuhet në fillim, por as që është dashur të thuhet se këtë do të duhej ta dinim të gjithë.

Në teorinë praktike juridike shtrohen arsyet e shpeshherë të nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin të pjesërishëm apo të tërësishëm të ligjit dhe këtu është shtruar pyetja për një ndryshim gjegjësisht plotësim të pjesërishëm. Dhe ligji është aprovuar, unë nuk dua të shkoj më tutje më.

Natyrisht, arsyetimi i paraqitur për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi themelimin e të drejtave në pronësinë e paluajtshme, Grupi Parlamentar i LDK e aprovon si të tillë dhe unë eaprovoj dhe paraqes disa arsyetime.

Duke ditur faktin se mbrojtja dhe siguria e të drejtave në regjistrimin e pronave të paluajtshme është një çështje me rëndësi dhe çështje përherë e hapur, nga se registrat e të drejtave të pronës së paluajtshme pothuaj

se deri më tani nuk janë mbajtur si duhet dhe se nuk është përcjellur e drejta e pronës prej një personi në personin tjetër në regjistrat adekuat, çka ka shkaktuar dhe do të shkaktojë probleme. Andaj, për të mund të realizohet ky ligj dhe ky ndryshim në këtë plotësimligj dhe sipas propozimit në nenin 3.3 nën a) dhe b) propozoj që Qeveria e Kosovës, Ministria për Shërbime Publike, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe drejtoritë kadastrale komunale të kërkojnë, me plotë të drejtë dhe këmbëngulësi nga UNMIK-u që nga Qeveria e Serbisë të sigurohet dokumentacioni adekuat me rëndësi madhor që do të vërtetonte pronësinë dhe pronarin e vërtetë të pronësisë së paluajtshme në Kosovë dhe ai të mbështetet në këtë: inçizimin ajror të tërësishëm të pronës së paluajtshme në Kosovë të bërrë në vitin 1980. Po ju rikujtoj se në këtë vit, të gjithë kemi genë të obliguar që me, nië ngjyrë të bardhë të fiksojmë pasurinë tonë të paluajtshme – shtëpi, livadh, pronë, mal, fusha e tjera dhe ky dokumentacion është vërtetuar nga kadastrat e atëhershme të niveleve republikane në Beograd, Zagreb, Sarajevë, Ljubjanë, Shkup e tjera, pra ekziston edhe në Kosovë dhe ka ekzistuar dhe në bazë të këtij dokumentacioni të inçizimit ajror, në vitin 81, 82 dhe 83 janë lëshuar dokumenta adekuat zyrtar që kanë vërtetuar pronësinë dhe pronarin e vërtetë të pronësisë. Prandaj, pa këtë dokument, edhe ky plotësimndryshim i ligjit do të jetë i mangët dhe do të lindë nevoja që edhe një herë t'i hyjmë procedurës për plotësim dhe ndryshim, që në drejtësi është e arsyeshme.

Unë mendoj se ky inçizim, si fakt juridik, mundëson plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të propozuar për ndryshim dhe plotësim dhe është përkrahë nga Grupi parlamentar i LDK-ës dhe është në rrugë të mirë që ligji të jetë sa më përbajtësor dhe argumenhtues. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit, zoti deputet. Diskutues tjerë nuk ka.

Vë në votim në parim Projektligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për themelimin e regjistratit të të drejtave në pronën e paluajtshme.

Kush është për? Është shumica.

Kush është kundër? Le të numërohen votat. 11 kundër. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush nga votimi? I abstenim.

Konstatoj se me një abstenim dhe 11 vota kundër aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistratit të të drejtave në pronën e paluajtshme.

Ndërsa, Komisioni funksional, që do ta shqyrtojë këtë Projektligj është përsëri Komisioni për shërbimet publike, por edhe Komisioni për legjislacion ka interes në këtë materie dhe e shqyrton edhe si Komision i interesuar, përvèç si Komision kryesor.

E përmbyllim edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën vijuese: Parashtrimi i pyetjeve.

Nuk ka përgjigje në pyetjet që janë bërë me kohë por do të janë përgjigjet në pyetjet e deputetëve.

Pika e fundit e rendit të ditës është propozimi i rendit të ditës për seancën plenare për 5 qershor 2003.

Unë do ta lexoj propozimin e rendit të ditës dhe nëse keni ndonjë propozim plotësues për rendin e ditës, urdhëroni.

Vetëm ta lexoj rendin e ditës. Rendi i ditës, për Seancën plenare të 5 qershorit 2003 është:

- 1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për planifikimin hapësinor; dhe*
- 2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemën e ndihmës sociale.*

Është lajmëruar deputeti Alush Gashi përfjalë. Urdhëroni zoti deputet.

ALUSH GASHI:

Inderuari kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë,

Procesi i privatizimit është me rëndësi të posaçme për Kosovën. Fatkeqësisht, deri më tani, në këtë Kuvend, ne nuk kemi asnje informatë lidhur me atë proces.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, si dhe në konsultim me shumicën e grupeve parlamentare në këtë Kuvend, kërkoj nga Kryesia e Kuvendit që ta marrë në konsiderim propozimin tonë që kjo të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës në një nga seancat e radhës dhe të ftojë Përfësuesin special të Sekretarit të përgjithshëm të OKB, rrespektivisht një nga zëvendësit e tij që t'na informojë lidhur me këtë proces. Ju falemnderit.

KRESUESI BAJRAM KOSUMI:

Të falemnderit zoti Alush.

Kryesia do të marrë parasysh, dhe është mirë që edhe me shkrim t'ia dorëzoni Kryesisë propozimin, dhe do të vendosë Kryesia.

Konsideroj se rendi i ditës i seancës së ardhshme është miratuar siç e kemi paraqitur këtu.

Vetëm një sqarim, pasi ka paqartësi. Deputeti kërkoj që në një nga seancat e ardhshme, ndërsa do të votohet vetëm nëse është për seancën e ardhshme domosdo, por për njëren nga seancat e ardhshme Kryesia do ta marrë me shkrim dhe Kryesia radhitë në rend të ditës.

Është shumë e qartë. Deputeti Alush Gashi, kërkon të futet në rend të ditës në njëren nga seancat e ardhshme. A qëndroni pranë kësaj, zoti deputet. Atëherë u krye puna. Rendi i ditës për seancën e ardhshme është ai që lexova unë, kurse Kryesia do të fusë si pikë të rendit të ditës së veçantë propozimin e deputetit në njëren nga seancat e ardhshme.

SABRI HAMITI:

Zoti kryesues, nuk ka nevojë bre të bëjmë kaq të komplikuara sendet, që janë të thjeshta krejt – sërç janë, të pastra. Ky është një propozim rend dite. Ky s'do të thotë hiq, edhe s'është e sigurt qindpërqind se do të jenë këto pika të rendit të ditës sot një javë. E din edhe ti mirë, sepse kalojnë edhe një herë për Kryesi, dalmi probleme tjera, e tjera, e tjera.

Sot ne, në parim, mbështesim këto dy pika të rendit të ditës, por ne ofrojmë një pikë të re të rendit të ditës. Ju lutem shumë. Nëse doni, unë po ju them dhe njeriu, zoti Alush Gashi që është zëvendësshef i Grupit Parlamentar ju propozoj në emër të Lidhjes Demokratike që kjo të shqyrtohet në Kryesi dhe të hyjë si temë tepër e rëndësishme në rendin e ditës të Kuvendit. A jemë të zot ne dhe ju si Kryesi ta bëjmë për mbledhjen e ardhshme, do të shohim. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI:

Nuk mund natyrisht të mospërkrahet një kërkesë e tillë, por kërkesa do të duhej të shtrohej në mënyrë të rregullt procedurale. Dhe ne... Parlament është zonja dhe zotërinj deputetë, prandaj edhe duhet, për fat të keq, të flasim për rregulla e për procedurë. Hiq s'më pëlqen. Dhe, tani ne kemi një mundësi... kemi edhe një mundësi që ta lexojmë Rregulloren dhe kemi mundësi që ta shqyrtojmë propozimin që është

bërë nga Kryesia. Kemi mundësi ta kundërshtojmë ndonjë pikë dhe pastaj në atë rast është paraparë procedura çka duhet të bëjmë. Përndryshe, unë dua ta informoj Kuvendin se kjo çështje pret në ajendat e Kuvendit ka kohë dhe është parashtruar me shkrim nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Është parashtruar me nënshkrime të deputetëve dhe ata që janë në Kryesi e dijnë se me forma të ndryshme është shtyrë e është lënë pastaj për më vonë kur të përgatiten kushtet. Prandaj, ne e mbështesim si kërkesë por kërkojmë që të procedohet siç kemi proceduar ne dhe përsëri kemi patur vështirësi. Ju falemnderit.

KRYESUESI BAJRAM KOSUMI:

Jo, nuk ka debat. Ju lutem, Bujar. Unë tolerova sepse kishte pakënaqësi. Përndryshe, Rregullorja ... Unë e kam të shkruar këtu prandaj edhe fola, ju se keni të shkruar përpara. Rregullorja më jep drejtë mua dhe juve Alush Gashi në emër të Grupit Parlamentar t'juajin. Ne do të thotë e përkrahim, Kryesia do ta shqyrtojë dhe përmbyllim rendin e ditës të seancës së sotme.

Ju falemnderit për kontributin e dhënë.

Seanca përfundoi në orën 12,40.

Rt/1-50